



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.53, datë 20.12.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
NR. 5, DATË 22.02.2023 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS
KANALIZIME TIRANË SH.A ”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.12.2024 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 5, datë 22.02.2023 “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a”

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Tiranë me shkresën nr. 19164 prot., datë 13.12.2024, me lëndë “Njoftim për ndryshimin e drejtuesit ligjor të shoqërisë” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit, e ndryshuar.
3. KKRR ka licencuar Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë me vendimin nr. 5, datë 22.02.2023 “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a”, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria

autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, përpunimin e ujit për konsum publik dhe largimin e ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë z. Kostandin Budurushi ka përfunduar studimet e larta në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, dega Teknolog në vitin 1990 dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Hidroteknikë në vitin 2004.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 2a të vendimit të KKRR nr. 5, datë 22.02.2023 “Për licencimin e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues Ligjor z. Kostandin Budurushi”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE

EVIS SHURDHA